



Republika e Kosovës / Republika e Kosovës
Kosovo Government / Kosova - Qeveria
Ministry of Foreign Affairs / Ministria e Jashtme

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

NDËRMJET

AKADEMISË DIPLOMATIKE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

DHE

SOCIETÀ' ITALIANA PER L'ORGANIZZAZIONE INTERNAZIONALE - SIOI

(SHOQËRISË ITALIANE PËR ORGANIZIM NDËRKOMBËTAR)¹

Akademia Diplomatike e Republikës së Kosovës dhe Shoqëria Italiane për Organizim Ndërkombëtar -SIOI, (këtu e tutje referuar si "Palët Nënshkruese"), me dëshirën për të vendosur dhe zhvilluar bashkëpunimin në lidhje me hulumtime të përbashkëta dhe trajnim të stafit diplomatik, kanë arritur mirëkuptimin e mëposhtëm:

Neni 1

Protokolli ka për qëllim krijimin e kushteve për mbajtjen e kontakteve të rregullta dhe bashkëpunimit në fushat e arsimit dhe të shkencës në kuadër të programit dhe aktiviteteve të Palëve Nënshkruese. Palët Nënshkruese do të fokusohen në prezantimin dhe elaborimin e metodave moderne për trajnimin e diplomatëve në fushat përkatëse.

Neni 2

Prioritetet e këtij bashkëpunimi janë:

1. Trajnimi profesional dhe përmirësimi i kualifikimeve të diplomatëve në fushat e mëposhtme:
 - Politikën e jashtme
 - Marrëdhëniet ndërkombëtare

¹ KY DOKUMENT NUK ËSHTË NË GJUHËN ORIGJINALE!

- Integrimin Evropian
- Diplomacinë Ekonomike
- Sigurinë ndërkombëtare dhe menaxhimin e konfliktit
- Negociatat ndërkombëtare
- Ngritjen e kapaciteteve në trajnime diplomatike

Neni 3

Palët nënshkruese do ta realizojnë bashkëpunimin përmes:

1. Programeve të trajnimit bazik dhe të specializuar;
2. Shkëmbimit të diplomatëve, ligjëruesve dhe hulumtuesve/ekspertëve;
3. Shkëmbimit të përvojave mbi aktivitetet relevante arsimore dhe çështjeve që lidhen me metodologjinë e mësimdhënies;
4. Realizimit të projekteve të përbashkëta në fushat me interes të përbashkët;
5. Pjesëmarrjes në konferenca, simpoziume dhe diskutime në panele.
6. Bashkëpunimit në përgatitjen e kualifikimeve, punën akademike
7. Shkëmbimin e burimeve arsimore, librave, publikimeve dhe artikujve

Neni 4

Kushtet financiare

Format, kohëzgjatjet dhe kushtet financiare në lidhje me shkëmbimin dhe trajnimin e përfaqësuesve të Palëve Nënshkruese do të dakordohen ndërmjet Palëve Nënshkruesve.

Neni 5

Përfaqësuesit e njëjës palë mund të marrin pjesë në konferenca, simpoziume, dhe tryeza të rrumbullakëta të organizuara nga pala tjetër nënshkruese. Palët nënshkruese do të informojnë njëra-tjetrën për këto ngjarje.

Palët nënshkruese do të promovojnë organizimin e konferencave dhe simpoziumeve të përbashkëta si dhe realizimin e projekteve me interes të përbashkët.

Palët nënshkruese do të bashkëpunojnë në kuadër të forumeve dhe organizatave ndërkombëtare, në të cilat ata kanë përfaqësuesit e tyre.

Neni 6

Palët Nënshkruese do të mbështesin organizimin e ligjëratave dhe fjalimeve të ekspertëve nga të dyja palët për çështje me interes të përbashkët.

Neni 7

Mosmarrëveshjet dhe kontestet lidhur me interpretimin ose zbatimin e këtij Memorandumi do të zgjidhen ndërmjet Palëve përmes konsultimeve.

Dispozitat e këtij protokollit mund të ndryshohen me pëlqim të ndërsjellë me shkrim të Palëve.

Neni 8

Hyrja në fuqi

Ky Memorandum do të hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të tij dhe do mbetet në fuqi, përveç nëse njëra nga Palët, të paktën tre muaj më parë, njofton palën tjetër me shkrim për qëllimin e shfuqizimit të këtij Memorandumi.

NË DËSHMI TË KËSAJ, të nënshkruarit e mëposhtëm , të autorizuar në mënyre të duhur, kanë nënshkruar këtë Memorandum.

NËNSHKRUAR më 12 nëntor 2013, në dy kopje në gjuhë Angleze.

Për Akademinë Diplomatike
Republika e Kosovës

Për Shoqërinë Italiane për Organizim Ndërkombëtar

Albert Prenkaj, Ambasador

Franco Frattini, President

SHTOJCA 1- SIOI

Bashkëpunimi në mes të dy palëve përfshin fushat e mëposhtme:

- Programe trajnimi kushtuar diplomatëve të rinj nga Kosova në fushën e Çështjeve Evropiane, Gjeopolitikës dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare;
- krijimin e projekteve të përbashkëta në fusha me interes të përbashkët, në veçanti në kuadër të programeve të BE-së;
- shkëmbimin e stafit akademik për qëllime të ligjërimit, studimit, hulumtimit dhe mbikëqyrjes së hulumtimit të studentëve;
- lehtësimin e shkëmbimit të folësve dhe ekspertëve të konferencave;
- shkëmbimin e informatave lidhur me aktivitetet me interes të përbashkët, duke marrë në konsideratë pjesëmarrjen e mundshme të përbashkët në takimet dypalëshe, rajonale dhe ndërkombëtare.